



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Nr. 630 Prot

Tiranë, më 15.12.2022

**Lënda:** Mbyllje e procedurës të pranimit në shërbimin civil gjyqësor lidhur me pozicionin e punës “Sekretar Gjyqësor”.

**Drejtuar: KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

**TIRANË**

**Të nderuar,**

Bazuar në ligjin nr.98/2016 “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Vendimit nr.622, datë 10.12.2020 “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor” të KLGJ, Udhëzimit nr.85, datë 11.03.2021 “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe pranimin nëpërmjet konkurrimit të hapur” me anë të të cilit janë përcaktuar rregulla të hollësishme për procedurën e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor, si dhe shpalljes nr. 574 prot., datë 15.11.2022 të Gjykatës Administrative të Apelit si dhe faktit të kualifikimit të kandidatës në procedurën e lëvizjes paralele në shërbimin civil gjyqësor për pozicionin “Sekretar Gjyqësor” shpallur me shpalljen nr.574 prot., datë 15.11.2022 nga Këshilli i Gjykatës, Ju njoftojmë:

Mbylljen e procedurës të pranimit në shërbimin civil gjyqësor lidhur me pozicionin e punës “Sekretar Gjyqësor” për shkak të kualifikimit të kandidatës në procedurën e lëvizjes paralele në shërbimin civil gjyqësor për pozicionin “Sekretar Gjyqësor” shpallur me shpalljen nr.574 prot., datë 15.11.2022 nga Këshilli i Gjykatës.

**Duke ju falenderuar,**

KANCELAR

Leonard STRATAJ

